

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS - kolegji i përbërë nga gjyqtarët Emine Mustafa kryetare e kolegjit, Avdi Dinaj dhe Valdete Daka anëtarë, me bashkëpunëtoren profesionale Mirlinda Mejzini procesmbajtëse, në çështjen penale kundër të pandehurve F. M., për shkak të dyshimit të bazuar se kanë kryer veprën penale marrja e ryshfetit nga neni 428 par.1 të KPK-së, dhe B. R. për shkak të dyshimit të bazuar se kanë kryer veprën penale prezantim i rremë si person zyrtar nga neni 417 par.2 të KPK-së, duke vendosur lidhur me kërkesën për mbrojtje të ligjshmërisë të mbrojtësit të të pandehurit F. M. paraqitur kundër aktvendimit të Gjykatës Themelore në Gjilan – Departamenti për Krime të Rënda PKR.nr.173/2015 të datës 22.12.2015 dhe aktvendimit të Gjykatës së Apelit të Kosovës, PN1.nr.143/16 të datës 28.01.2016, në seancën e kolegjit të mbajtur më 16.02.2016, mori këtë:

A K T G J Y K I M

I. Me aprovimin e kërkesës për mbrojtje të ligjshmërisë të mbrojtësit të pandehurit F. M., ndryshohet aktvendimi i Gjykatës Themelore në Gjilan – Departamenti për Krime të Rënda PKR.nr.173/2015 të datës 22.12.2015 dhe aktvendimi i Gjykatës së Apelit e Kosovës, PN1.nr.143/16 të datës 28.01.2016.

II. Ndaj të pandehurit F. M. ndërpritet masa e paraburgimit dhe i njëjtit lirohet menjëherë për tu mbrojtur në liri.

## A r s y e t i m

Gjykata Themelore në Gjilan – Departamenti për Krime të Rënda, me aktvendimin PKR.nr.173/2015 të datës 22.12.2015, të pandehurit F. M., për shkak të dyshimit të bazuar se ka kryer veprën penale marrja e ryshfetit nga neni 428 par.1 të KPK-së, ia ka vazhduar masën e paraburgimit për 2 (dy) muaj e cila do të llogaritet nga data 22.12.2015 deri më 21.02.2016. Masa e paraburgimit është caktuar në bazë të nenit 187 par.1 nënpar. 1.2 pikat 1.2.2, dhe 1.2.3 të KPPK-së.

Në procedurën ankimore, gjykata e Apelit e Kosovës me aktvendimin PN1.nr.143/16 të datës 28.01.2016, e ka refuzuar si të pabazuar ankesën e mbrojtësit të të pandehurit dhe e ka vërtetuar aktvendimin e shkallës së parë.

### *Paraqitësi i kërkesës për mbrojtje të ligjshmërisë dhe pretendimet e tij.*

Kundër këtyre aktvendimeve, kërkesë për mbrojtje të ligjshmërisë ka ushtruar mbrojtësi i të pandehurit F. M., av. B. J., për shkak të shkeljes së dispozitave të Kodit të procedurës Penale, dhe shkeljes së ligjit penal, me propozim që Gjykata Supreme e Kosovës ta ndërpres paraburgimin ose të caktojë ndonjë nga masat e paraqitjes në stacionin policor.

Në kërkesë për mbrojtjen e ligjshmërisë mbrojtësi i të pandehurit kryesisht thekson se aktvendimi mbi masën e paraburgimit është i pabazuar ngase në këtë fazë është ngritur aktakuza çka do të thotë se ka përfunduar faza e hetimeve, janë intervistuar të gjithë dëshmitarët, të pandehurit dhe nuk ekziston asnjë rrezik se i njëjti mund të ndikojë në dëshmitar apo në zhdukjen e provave. Mbrojtësi gjithashtu thekson se i pandehuri është duke u mbajtur në paraburgim më shumë se 5 muaj, madje me datën 26.01.2016 është caktuar seanca dhe nuk është mbajtur për shkak se trupi gjykues nuk ka qenë në përbërje të plotë, ndërsa i pandehuri po mbahet në paraburgim pa asnjë bazë ligjore.

### *Opinionit i Prokurorit të Shtetit lidhur me kërkesën për mbrojtjen e ligjshmërisë.*

Prokurori i Shtetit i Kosovës, me shkresën KMLP.III.nr.13/16 të datës 15.02.2016, ka propozuar që kërkesa për mbrojtjen e ligjshmërisë e mbrojtësit të të pandehurit F. M. të refuzohet si e pabazuar.

### *Gjetjet e Gjykatës Supreme*

Gjykata Supreme e Kosovës në seancën e kolegjit, i shqyrtoi shkresat e lëndës, vlerësoi pretendimet e kërkesave, dhe gjeti se:

- kërkesa për mbrojtjen e ligjshmërisë është e bazuar.

Sipas vlerësimit të kësaj gjykate pretendimet e mësipërme ankimore janë të bazuara për arsye si në vijim: aktvendimet e atakuara me kërkesë janë të përfshira me shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale, me çka me të drejtë kanë tërheq vërejtjen edhe mbrojtësit në kërkesë, ngase nuk ka arsye të mjaftueshme dhe bazë ligjore që të pandehurit në fjalë t'i caktohet masa e paraburgimit për faktin se arsyet që i ka dhënë gjykata e shkallës së parë e që pothuajse i ka përshkruar edhe gjykata e shkallës së dytë janë konfuze dhe pa arsyetim konkret, ngase për të përmbushur njëri nga kushtet për caktim të paraburgimit duhet të përmbushen kushtet e përcaktuara nga neni 187 par.1 nën par.1.1 dhe 1.2 pika 1.2.2 dhe 1.2.3 të KPRK-së.

Në bazë të analizimit nga aktvendimi i gjykatës së shkallës së parë për caktim të paraburgimit dhe ai i shkallës së dytë si dhe pretendimeve të parashtruara në kërkesë qartë shihet se nuk ekzistojnë asnjëra nga kushtet për caktim të paraburgimit, ngase në rastin konkret është ngritur aktakuza e me çka edhe ka perfunduar faza e hetimeve, janë marrë të gjitha deklaratat e dëshmitarëve dhe të pandehurve, siç shihet edhe në shkresat e lëndës, andaj nuk ka arsye që i pandehuri në fjalë të qëndroj në paraburgim pasi që i njëjti ndodhet që një kohët të gjatë dhe atë që nga data 26.09.2016.

Nga kjo rezulton se gjykata e shkallës së parë e as ajo e shkallës së dytë nuk ka dhënë arsye për faktet vendimtare që kanë bëjnë me bazën ligjore për caktimin e paraburgimit që kushtëzuan ndryshimin e aktvendimeve të atakuara me kërkesë.

Për arsyet e lartcekura e në bazë të nenit 438 par. 1 nënpar.1.1 të KPPK, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS PRISHTINË

Pml.nr.49/2016 datë 16.02.2016.

Procesmbajtësja,  
Mirlinda Mejzini

Kryetare e kolegjit,  
Emine Mustafa